



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 29.09.2024

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës – SHËRBIM

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Mbikëqyrje objekti “Ndërtim i ri gjimnazi Manëz, Njësia Administrative Manëz”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV: Shërbime për mbikëqyrje të ndërtimit- 71521000-6.

Në mbështetje të Ligjit Nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përbashkimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Vendimit të Komisionit Shtetëror Rindërtimit nr. 114, datë 16.04.2024; Vendimit Nr.225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumentave standarte të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, të ndryshuar;

Për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentat standarte “Procedurë e përsheptuar – rindërtimi punë”, lloji i procedurës “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit) të konfirmuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më poshtë:

Në lidhje me procedurat e prokurimit që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit, kuadri rregullator, përveç ligjit për prokurimin publik, përfshin Aktin Normativ nr. 9/2019, të miratuar me Ligjin 97/2019, si dhe VKM Nr.225 date 12.04.2021, me anë të të cilit janë miratuar dokumentet standarde të tenderit për këto procedura. Referuar këtyre dispozitave ligjore, hartimi i dokumentet standarde për procedurat e prokurimit për rindërtimin është kompetencë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, ndërkohë që APP publikon këto dokumenta.

Për sa më sipër, autoritetet kontraktore, për procedurat e rindërtimit, do të zbatojnë VKM Nr.225 date 12.04.2021 dhe do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të miratuara me këtë vendim, edhe pse në këto DST nuk parashikohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.

VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL: 3.667.131,97 (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e një presje nëntëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj.

Afatet e ekzekutimit: Afati i realizimit të mbikëqyrjes së punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e publikuar të realizimit të punimeve.

Argumentim: MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrin Nr.249, datë 18/07/2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.195 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2024”.
2. Shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga: Grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit, grupi i punës u mbështet në: Specifikimet teknike, preventivin e punimeve dhe projektin të zbatimit të hartuar nga studio e projektimit. Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

PËRCAKTIMI I VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës marrëveshjes kuadër me objekt: Mbikëqyrje objekti “Ndërtim i ri gjimnazi Manëz, Njësia Administrative Manëz”, grupi i punës ju referua preventivit të punimeve të hartuar nga projektuesi dhe VKM nr. 354 dt.11.05.2016, Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimin si dhe shtojcës përkatëse.

Mbështetur në tabelën 6 të Nenit 25, “Tabela shoqëruese e tarifave - Seksioni I, Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre”, Grupi i VI tarifor dhe në tabelën 56 të Nenit 56 pika 1, “Tabela shoqëruese e tarifave - Seksioni II, Sistemet teknike.”, Grupi i III tarifor.

Në përfundim të punës së grupit u vendos se:

Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull Mbikëqyrje objekti “Ndërtim i ri gjimnazi Manëz, Njësia Administrative Manëz”, rezultoi të jetë: 3.667.131,97 (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e një presje nëntëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuar, vendosur dhe përllëgëritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllëgëritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Përshkrimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 3*;
 - b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas *Shtojcës 4*;
 - c. Sigurim oferte sipas *Shtojcës 5*;
 - d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas *Shtojcës 7*;
 - e. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas *Shtojcës 8*;
 - f. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës *Shtojcës 10*;
 - g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale, sipas *Shtojcës 11*;
 - h. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77, 83, 87 të LPP-së nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 29,30, të VKM - së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar..*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1.400,000 lek.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për

sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara te kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 1.400,000 lek.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar referuar fondit limit, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të vlefshme për mbikqyrjen dhe kolaudim te punimeve objekt i kontrates, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Licencë profesionale të shoqërisë për supervizion punimesh te vlefshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë si më poshtë ose ekuivalente te tyre:

Punime të Përgjithshme Ndërtimi

- N.P-1 Punime gërmimi në tokë;
- N.P-2 Ndërtime civile e industriale;
- N.P-7 Ujësjetës, gazsjellës, vajsjetës , vepra kullimi dhe vaditje
- N.P-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Punime Speciale Ndërtimi:

- N.S-1 Punime per prishjen e ndertimeve
- N.S-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- N.S-3 Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues)
- N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknikendërtues;
- N.S-9 Punime strukturore speciale
- N.S-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- N.S-14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- NS-18 Punime topogjeodezike
- NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike

Licenca duhet te jete lëshuar sipas rregullave te VKM nr.759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" i ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016. Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.*

Licensat e mësipërme kërkohen në bazë të zbërthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve, në zbatim të VKM, Nr. 42, Datë 16.1.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Sipas lidhjes Nr.2 dhe lidhjes Nr.4.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listë të personelit kryesor (drejtues teknik), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponentëve të saj, si dhe CV-në e tyre, diplomat, kontratë individuale pune të noterizuar dhe licencën personale të mbikëqyrjes të tyre. Drejtuesit teknike të kërkuar më poshtë duhet

të figurojnë në listepagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar për 3 muajt e fundit nga dita e hapjes së tenderit (formulet E-ig025/a.1):

Ka si drejtues teknik të punësuar dhe të përfshirë në liçencën e shoqërisë minimalisht:

• Inxhinier Ndërtimi (Profil Strukturist)	1(nje)
• Inxhinier Ndërtimi	1(nje)
• Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder	1 (një)
• Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
• Inxhinier Mekanik	1 (një)
• Inxhinier Elektrik	1 (një)
• Inxhinier Gjeolog	1 (një)
• Inxhinier Mjedisi	1 (një)
• Arkitekt	1 (një)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën **3 (tre) muajt e fundit**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. **Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.**

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë staf ndihmës vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë/deshmi kualifikimi dhe të vërtetuar në listpagesa për Periudhën muajin e fundit, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektronik
- 1 (një) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 41, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për shërbimin e

mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin“, ku citohet se: ”Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep 8ertifikate për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

- 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 4, gërma (b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Argumentimi: Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjes te pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave".

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Specialist per testimin e performances se produketeve te ndërtimit" e cila të jetë e lëshuar nga instituti i ndërtimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Argumentimi: Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Specialist per testimin e performances se produketeve te ndërtimit" për kontrollin e cilësis së produketeve të ndërtimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin ndihmes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për stafin ndihmes në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes se punimeve te zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit ndihmes është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per periudhen 3 (tre) muajt e fundit, tregon besueshmëri

për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë minimalisht 15 (pesëmbëdhjet) persona për periudhën 3 (tre) muajt e fundit e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punonjës të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Në përcaktimin e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar tek zërat e punimeve, etj... Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Në numrin total të punonjësve të kërkuar janë përfshirë stafit inxhinierik i kërkuar në license si dhe ai i kërkuar mbështetës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- Çertifikatën e menaxhimit të ambientit ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) ose ekuivalente të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.
- Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2011 (e vlefshme) ose ekuivalente të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera Pajisjet Gjeodezike si më poshtë :

- 1(një) Pajisje Total Station /1(një) Pajisje GPS

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i azhurnuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Licensat e mësipërme kërkohen në bazë të zbërthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve, në zbatim të VKM, Nr. 42, Datë 16.1.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Sipas lidhjes Nr.2 dhe lidhjes Nr.4.

Termat e references dhe procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim, të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë bashkëngjitur.

Specifikime teknike/termave te references, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e meposhteme:

1. Emri dhe adresa e autoritetit pergjegjës

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Fax 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Faqja e Internetit www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës se prokurimit: Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Mbikëqyrje objekti “Ndërtim i ri gjimnazi Manëz. Njësia Administrative Manëz”.

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-21928-09-27-2024

5. Fondi / vlera e përafërt e kontratës: 3.667.131.97 (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e një presje nëntëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj.

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **10.10.2024** Ora: **10:00**
Vendi: Prokurim elektronik www.app.gov.al

8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **10.10.2024** Ora: **10:00**
Vendi: Prokurim elektronik www.app.gov.al

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit